

VENDIM
Nr.422, datë 2.7.2004
PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rriten në masën 15 për qind.

3. Rritje pensioni përfitojnë:

a) në masën 8 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat të jepen duke filluar nga data 1.7.2004, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë.

b) në masën 15 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat të jepen duke filluar nga data 1.7.2004, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2004 e në vazhdim, të jenë jo më pak se 7 266 lekë në muaj dhe jo më shumë se 14 532 lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuar sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2004, në vazhdim nuk caktohen më pak se 2 980 lekë në muaj.

6. Rritja e pensioneve të parashikuara nga ky vendim të zbatohet mbi masën që rezulton nga shuma e pensionit plus shtesat e dhëna sipas neneve 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

7. Shtesa mujore e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të rritet në masën 8 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994, të rriten në masën 8 për qind.

9. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për vitin 2004 llogariten në shumën 1 552 milionë lekë dhe të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë qëllim në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano